

Sokol Zeneli dhe Egzon Gajtani
Tetor 2025

Hendeku Digjital: Nga Mangësia në Goditje

Vlerësimi i Kornizës Rregullatore të
Kosovës kundër Hendekut Digjital



Imprint

Botuesi

Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra në Prishtinë
Rr. Pashko Vasa Nr. 23
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Përgjegjësia për përmbajtjen dhe redaktimin

Katharina Hofmann

Kontakti

Rudina Nallbani
rudina.nallbani@fes.de

Dizajni/Faqosja

Trembelat

Shtypja dhe prodhimi

Studio Forma

Ky dokument është shkruar fillimisht në anglisht. Në rast të ndonjë paqartësie ose mospërputhjeje, ju lutemi referojuni versionit në anglisht të dokumentit. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk janë domosdoshmërisht ato të Friedrich-Ebert-Stiftung e.V. (FES). Përdorimi komercial i mediave të publikuara nga FES nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të FES. Publikimet e FES nuk mund të përdoren për qëllime fushate zgjedhore.

Tetor 2025

© Friedrich-Ebert-Stiftung e.V.

Publikime të mëtejshme të Friedrich-Ebert-Stiftung mund të gjenden:

➤ www.fes.de/publikationen

Sokol Zeneli dhe Egzon Gajtani
Tetor 2025

Hendeku Digjital: Nga Mangësia në Goditje

Vlerësimi i Kornizës Rregullatore të
Kosovës kundër Hendekut Digjital

Përmbajtja

Mirënjohe	3
Rekomandime	3
Hyrje	4
Metodologjia	6
Hendeku digjital: Nga mangësia në goditje	9
Kuadri rregullativ	14
Aplikimi i Kornizës së analizimit të politikave	17
Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi	17
Ligji nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike	18
Projekti i Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE)	19
Strategjia e Arsimit 2022 - 2026	20
Agjenda Digjitale e Kosovës 2030	21
Strategjia dhe Plan i Kombëtar për Zhvillim (SPKZH) 2030	22
Strategjia për Zhvillimin Industrial dhe Mbështetjen e Bizneseve 2030 (Politika Industriale)	23
Strategjia e Qeverisjes Elektronike të Kosovës 2023 - 2027	24
Diskutimi i gjetjeve	26
Konkluzione dhe rekomandime	28

Rekomandime

Në vijim janë rekomandimet kryesore të propozuara për hartimin e një kornize më reziliente rregullatore dhe shoqërore:

- Të iniciohet hartimi i Strategjisë shtetërore e edukimit digjital multimodal – Qeveria duhet ta reformojë kurrikulën kombëtare bazë për të integruar edukimin digjital dhe mediatik si zotësi ndërsektoriale në të gjitha lëndët dhe nivelet shkollore. Modeli i aplikuar nga Finlanda mund të shërbejë si pikënisje frymëzuese.
- Të krijohet një ekosistem shërbimesh publike me kanale të shumta – Qeveria duhet të lansojë një rrjet kombëtar të “Qendrave të Qytetarëve” për të ofruar mbështetje digjitale, duke e bërë me ligj të detyrueshme mbështetjen digjitale të asistuar me alternativa jo-digjitale për të gjitha shërbimet elektronike.
- Të lidhet mbështetja për digjitalizimin e NVM-ve me avancimin strategjik të shkathtësive – Qeveria duhet t’i kushtëzojë të gjitha subvencionet për digjitalizim për NVM-të me hartimin paraprak të planit formal për digjitalizim dhe avancim të shkathtësive të punonjësve, në përputhje me strategjitë e tjera kombëtare digjitale.
- Të krijohet një mekanizëm për reagim emergjent – Qeveria duhet të krijojë një Fond Kombëtar Emergjent Digjital për blerjen e shpejtë të pajisjeve dhe lidhjes digjitale gjatë krizave, plotësuar me Protokoll të Përfshirjes Digjitale për Reagim të Shpejtë me një skemë paraprake të kuponëve socialë.

Mirënjohje

- Ky dokument politikash u zhvillua si pjesë e projektit “Vlerësimi i Rezistencës së Shoqërisë Kosovare ndaj Goditjeve Ekologjike dhe Institucionale”. Një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse e vlerësimit, e cila mbështet analizën e paraqitur këtu, është në dispozicion me kërkesë. Ju lutemi dërgoni kërkesat tuaja në info@re-actlab.org

- Të fuqizohen garancitë ligjore për të drejtat digjitale – Qeveria duhet ta ndryshojë e plotësojë Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi për të ndaluar shprehimisht përjashtimin digjital dhe të përligj mandatin e “Përfshirjes Strukturore Digjitale”, që kërkon që të gjitha shërbimet esenciale të jenë në përputhje me Aktin Evropian për Qasshmëri.

Dekada e fundit është karakterizuar me digjitalizim të shpejtë dhe zgjerim të teknologjive digjitale në të gjitha sferat e shoqërisë, duke sjellë një transformim të mënyrës se si jetojmë, komunikojmë dhe punojmë. Ndonëse ky transformim përgjithësisht konsiderohet si zhvillim pozitiv, ai gjithashtu ka nxjerrë në pah rreziqe të tjera që kanë pasoja të thella për ekonominë, barazinë shoqërore dhe funksionimin efektiv të institucioneve. Një nga rreziqet kryesore në këtë drejtim është hendeku digjital, sfidë kjo që rrezikon të thellojë përjashtimin shoqëror.

Hendeku digjital nuk ka të bëjë më vetëm me qasjen në internet; ajo shfaqet si pabarazi e thellë në shkathtësitë digjitale, cilësinë dhe përballueshmërinë, si dhe aftësinë për të përdorur në mënyrë domethënëse teknologjinë për angazhim ekonomik, arsimor dhe qytetar. Çështja e hendekut digjital nuk është diçka e papritur, por fenomen afatgjatë që është shfaqur në mbarë botën, duke u ndjerë më shumë në vendet dhe rajonet më pak të zhvilluara. Kjo “goditje” ka potencial që të zbeh reziliencën shoqërore dhe institucionale, duke krijuar një disbalancë mes teknologjisë dhe shërbimeve digjitale në dispozicion, qasshmërisë së tyre dhe aftësisë apo kapacitetit për t’i përdorur apo përballuar ato.

Shoqëria dhe institucionet në Kosovë janë gjithnjë e më të ndjeshme ndaj “goditjes” së hendekut digjital, veçanërisht për shkak të rrugëtimit të vendit drejt integritimit në BE dhe reformave që kanë të bëjnë me transformimin digjital intensiv. Me progresin aktual në këtë drejtim, Kosova përballlet me një “paradoks të ndjeshëm mbulimi”. Ndonëse është shënuar progres i konsiderueshëm në ofrimin e internetit për 96% të ekonomive familjare, kjo shifër e shpërfaq vetëm gjysmën e historisë. Shumica e përdoruesve (rreth 87%) në Kosovë përdorin mjete digjitale për komunikim bazë dhe rrjete sociale, ndërsa përdorimi i mjeteve digjitale për shkathtësi të

“Hendeku digjital nuk ka të bëjë më vetëm me qasjen në internet; ajo shfaqet si pabarazi e thellë në shkathtësitë digjitale, cilësinë dhe përballueshmërinë, si dhe aftësinë për të përdorur në mënyrë domethënëse teknologjinë për angazhim ekonomik, arsimor dhe qytetar.”

avancuara ose përfitim ekonomik vazhdon të jetë shumë i ulët. Po ashtu, edukimi digjital dhe kapaciteti për t'i përdorur mjetet digjitale janë ende në nivel të ulët. Ekziston një hendek kritik i shkathtësive, që përfaqëson një dështim sistematik arsimor për t'iu adaptuar epokës digjitale, veçanërisht në zonat rurale dhe brenda grupeve të marginalizuara. Kjo çon në thellimin e hendekut digjital, gjë që në afat të gjatë kontribuon në thellimin e pabarazive ekzistuese shoqërore.

Kjo përmbledhje politikash përdor një kornizë sistematike të analizës së politikave për të vlerësuar reziliencën e kuadrit rregullator ekzistues të Kosovës përballë “goditjes” së hendekut digjital. Duke përdorur kornizën e “4R-ve të Reziliencës”, kjo analizë shqyrton efektivitetin e ligjeve, politikave dhe strategjive kryesore për t'i bërë ballë këtij stresori afatgjatë. Seksioni vijues shpjegon metodologjinë analitike të aplikuar për këtë vlerësim. Tutje, do të paraqitet një hartëzim i kuadrit relevant rregullator, vijuar me aplikimin e kornizës së 4R-ve të reziliencës. Në fund, ky dokument politik paraqet një diskutim mbi gjetjet dhe ofron përfundime dhe rekomandime mbi ndërtimin e reziliencës kundër “goditjes” së hendekut digjital.



Kjo përmbledhje politikash është pjesë e një hulumtimi më të gjerë mbi goditjet institucionale me të cilat përballet Kosova. Ky hulumtim aplikon një kornizë sistematike të analizimit të politikave, e projektuar për të vlerësuar reziliencën e kornizës ekzistuese rregullatore të Kosovës (politika, ligje, akte nënligjore, strategji, dokumente qeveritare etj.) ndaj disa goditjeve. Procesi i hulumtimit ka ndjekur një rrjedhë të strukturuar të përbërë nga tri faza kryesore: (i) identifikimi i natyrës së goditjes, (ii) vlerësimi i reagimeve aktuale të politikave përmes një sistemi të vlerësimit, dhe (iii) hartimi i rekomandimeve të bazuara në gjetjet dhe praktikatat më të mira.

Klasifikimi i natyrës së goditjeve bazohet në kuadrin e zhvilluar nga OECD në vitin 2014, siç shpjegohet në tabelën më poshtë:

Tabela 1. Klasifikimi i goditjeve¹

Llojet e goditjeve	Karakteristikat	Shembuj
Goditjet kovariante (Të përhapura, sistemike dhe jo të shpeshta)	Ngjarje në shkallë të gjerë që kanë ndikim në një pjesë të madhe të popullsisë përnjëherë. Nuk ndodhin shpesh, por ndikimi i tyre është i gjerë dhe sistematik.	Konfliktet e dhunshme dhe krizat politike, pandemitë dhe krizat shëndetësore, fatkeqësitë natyrore në nivel të gjerë, kërcënimet kibernetike dhe hibride.
Goditjet sezonale (Të përsëritura, të parashikueshme dhe të lokalizuara)	Goditje periodike që ndodhin në intervale të rregullta, shpeshherë të lidhura me ndryshimet sezonale ose trendet klimatike. Zakonisht të parashikueshme, por mungesa e përgatitjes adekuate mund ta përkeqësojë ndikimin e tyre.	Përmytjet dhe thatësitat vjetore, valët e nxehtësisë dhe të ftohtit, pasiguritë sezonale të ushqimit, rreziqet shëndetësore që përsëriten.
Stresorët afatgjatë (Erozion i ngadalshëm, kumulativ dhe sistemik i reziliencës)	Ndryshe nga goditjet, stresorët afatgjatë zhvillohen ngadalë, përgjatë kohës, dhe dobësojnë sistemet shoqërore. Ata janë shpeshherë goditje strukturore, mjedisore, ekonomike ose shoqërore që kërkojnë reagim politikash.	Degradimi mjedisor, ndryshimet demografike, stagnimi ekonomik dhe pabarazia, institucione dhe qeverisje të dobëta.

¹ Klasifikuar bazuar në dokumentin e OECD-së (2014) "Udhëzimet për analizën e sistemeve të reziliencës: Si të analizohen rreziqet dhe të ndërtohet një udhërrëfyes për reziliencë". Botim i OECD.

Për të vlerësuar efektivitetin e kuadrit rregullator në përballimin e goditjeve të ndryshme, mbështetemi në kornizën e 4R-ve të Reziliencës. Kjo kornizë vlerëson politikat kundrejt katër dimensioneve kryesore të reziliencës:

Tabela 2: 4R-të e Kornizës së Reziliencës

Korniza	Kategoria	Përkufizimi
4R-të e Reziliencës	Qëndrueshmëria (Robustness)	Fuqia apo aftësia e elementeve, sistemeve dhe njësive të tjera të analizës për t'i bërë ballë një niveli të caktuar stresi ose kërkesë pa pësuar degradim apo humbje funksioni.
	Kapacitetet rezervë (Redundancy)	Disponueshmëria e burimeve alternative gjatë procesit të rimëkëmbjes së një sistemi.
	Resurset	Kapaciteti për t'i identifikuar problemet, përcaktuar prioritetet dhe mobilizuar resurset kur mbizotërojnë kushte që mund të rrezikojnë ndërprerjen e ndonjë elementi, sistemi ose njësie tjetër të analizës.
	Shpejtësia (Rapidity)	Kapaciteti për t'i përmbushur prioritetet dhe arritur objektivat në kohë, në mënyrë që të kufizohen humbjet dhe të evitohen pengesat e ardhshme.

Çdo burim i identifikuar si pjesë e kuadrit rregullator që adreson goditjet vlerësohet kundrejt kuadrit të 4R-ve duke përdorur një sistem të strukturuar vlerësimi, siç shpjegohet më poshtë:

Tabela 3. Sistemi i vlerësimit i bazuar në Kornizën e 4R-ve

Vlerësimi	
Qëndrueshmëria (Robustness)	0: Mungesë e qëndrueshmërisë - politika nuk adreson stabilitetin përballë goditjeve. 1: Masa të dobëta ose simbolike me pak zbatim. 2: Ka mekanizma të moderuar, por nuk zbatohen në mënyrë konsistente. 3: Mekanizma të fortë me zbatim të mirë që sigurojnë stabilitet.
Kapacitetet rezervë (Redundancy)	0: Nuk ka kapacitete rezervë - dështimi i sistemit kryesor çon në kolaps. 1: Alternativa minimale ose joformale që nuk janë të besueshme. 2: Ka pak kapacitete rezervë, por ekzistojnë zbrazëtira në mbulim ose efikasitet. 3: Kapacitete rezervë të mirë integruara që sigurojnë vazhdimësinë nën stres/goditje.
Resurset	0: Nuk ka resurse - qasje reaktive në vend të asaj proaktive. 1: Përshtatshmëri e kufizuar - mekanizmat e reagimit janë të dobët ose ad hoc/momental. 2: Aftësi mesatare për t'i mobilizuar resurset, por ende ka boshllëqe. 3: Mekanizma reagimi shumë fleksibil dhe të koordinuar mirë.
Shpejtësia (Rapidity)	0: Nuk ka mekanizma të reagimit të shpejtë - reagime të vonuara ose mungojnë fare. 1: Reagim i ngadaltë dhe burokratik me joefikasitete të mëdha. 2: Shpejtësi mesatare, por me disa pengesa. 3: Reagim shumë efikas dhe i shpejtë që siguron veprim të shpejtë.

Nota totale e reziliencës së politikave (0-12) normalizohet më pas në përqindje, duke mundësuar vlerësim krahasues midis politikave dhe sektorëve të ndryshëm.

Rezultati i reziliencës = SHUMA (Rezultati total/12) x 100

Tabela 4. Interpretimi i vlerësimit

Interpretimi i vlerësimit		
0-25% (0-3 pikë)	Reziliencë shumë e ulët	Politika e lë shoqërinë në nivel tejet të ndjeshëm ndaj goditjeve, duke ofruar pak mbrojtje ose aftësi reagimi.
26-50% (4-6 pikë)	Reziliencë e ulët	Ekzistojnë disa masa të reziliencës, por ato janë të dobëta, jokonsistente ose të paplota.
51-75% (7-9 pikë)	Reziliencë mesatare	Politika siguron një nivel të arsyeshëm të përgatitjes dhe reagimit, por mbesin disa boshllëqe kritike.
76-100% (10-12 pikë)	Reziliencë e lartë	Politika është e hartuar mirë, me mekanizma të fortë që sigurojnë stabilitet, përshtatshmëri dhe reagim të shpejtë.

Për metodologji më të detajuar hulumtuese, ju lutemi referojuni Kornizës së Analizimit të Politikave të hartuar për këtë hulumtim. Mund ta gjeni në këtë [link](#).

Hendeku digjital: Nga mangësia në goditje

Hendeku digjital është një formë shumëdimensionale e pabarazisë që i referohet hendekut midis individëve, ekonomive familjare, bizneseve dhe zonave gjeografike në nivele të ndryshme socio-ekonomike, lidhur me mundësitë e tyre për të pasur qasje, përdorim dhe përfitim nga Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK).² Ky koncept është zhvilluar nga një ndarje e “nivelet të parë”, e fokusuar vetëm në qasjen fizike në internet dhe pajisje, drejt një ndarjeje të “nivelet të dytë”. Ky nivel i dytë fokusohet në pabarazitë në shkathtësitë digjitale, natyrën dhe cilësinë e përdorimit, si dhe kapacitetin për të arritur rezultate konkrete në arsim, punësim dhe jetën qytetare.³ Kjo ndarje nuk është statike; me avancimin e teknologjisë nëpër valë të ndryshme inovacioni (p.sh. nga rrjeti brezgjërë (broadband) deri te inteligjenca artificiale), ajo transformohet vazhdimisht, duke krijuar forma të reja përjashtimi dhe duke sfiduar adaptimin institucional.⁴

Ndryshe nga ngjarjet e menjëhershme, hendeku digjital është stresor afatgjatë. Ky stresor shfaqet gradualisht ndërsa teknologjia përhapet në mënyrë të pabarabartë, duke u dhënë përfitime atyre që e adoptojnë të parët dhe duke krijuar varësi rrugësh që thellojnë shtresëzimin shoqëror me kalimin e kohës.⁵ Kjo goditje sfidon legjitimitetin e institucioneve (qoftë qeveria, shkollat, etj.) që perceptohen si të paafta për të siguruar pjesëmarrje të barabartë në një botë gjithnjë e më digjitale. Për këtë arsye, hendeku digjital kërkon rishikim të koncepteve tradicionale si “e mira publike” dhe “detyrimet e shërbimit universal”, duke nxitur një debat mbi faktin nëse qasja në broadband, edukimi digjital dhe përdorimi janë bërë shërbime thelbësore për qytetarinë moderne.⁶

Burimi: UNDP (2024)
Udhëzues i përfshirjes digjitale 2.0: Nga qasja te fuqizimi në një botë dinamike.




Figura 1: Hendeku i shpejtësisë me përshpejtim teknologjik.

2 OECD (2001) “Të kuptuarit e hendekut digjital”. OECD Dokumentet e ekonomisë digjitale, nr. 49.

3 van Dijk, J.A.G.M (2017) “Digital Divide: Impact of Access”. Enciklopedia ndërkombëtare e efekteve të medias.

4 Hilber, M (2011) “Rezultati justifikon përkufizimin:” “Perspektivat e shumëllojshme mbi hendekun digjital dhe dobia e tyre praktike për hartimin e politikave”. Politika e Telekomunikacionit.

5 Po aty 3

6 Sorj, B (2008) “Dimensioni i hendekut digjital”. Centro Edelstein de Pesquisa Social. SciELO Books.

Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit në vend lidhur me digjitalizimin, si dhe rrugën e Kosovës drejt integritimit në BE, e cila përfshin reforma madhore të lidhura me digjitalizimin, ndjeshmëria e saj ndaj goditjes së hendekut digjital është gjithnjë në rritje. Një çështje e rëndësishme në procesin e digjitalizimit në Kosovë është “paradoksi i mbulimit”. Nga njëra anë, vendi ka shënuar progres të jashtëzakonshëm në sigurimin e lidhjes bazë, duke arritur një normë depërtimi të internetit në ekonomitë familjare prej 96% që nga viti 2021 dhe pothuajse mbulim universal me internet.⁷ Ky progres është përshpejtuar ndjeshëm nga nisimat si ajo me projektin e mbështetur nga Banka Botërore për Ekonominë Digjitale të Kosovës (KODE), me të cilin u zgjerua qasja në broadband me shpejtësi të lartë në zonat rurale që më parë nuk kishin lidhje.⁸ Nga ana tjetër, kjo qasje mbresëlënëse sasiore fsheh mangësi të konsiderueshme cilësore dhe barriera të vazhdueshme në hapësirën digjitale. Komunitetet e marginalizuara (përfshirë romët, ashkallitë, egjiptianët, si dhe të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara) vazhdojnë të përballen me sfida të mëdha për shkak të të ardhurave të ulëta, arsimit të kufizuar dhe mungesës së mbështetjes së targetuar për qasje dhe përdorimin e teknologjive dhe shërbimeve digjitale.⁹

Për këto grupe, përballueshmëria mbetet shqetësim madhor, dhe edhe kur ekziston lidhja, mungesa e vetëdijes dhe e shkathtësive bën që platformat thelbësore si portali e-Kosova¹⁰ të përdoren shumë rrallë. Ky hendek konfirmohet edhe nga organizata ndërkombëtare që punojnë drejtpërdrejt me institucionet qeveritare. Përvoja e GIZ tregon se megjithëse shumë qytetarë, përfshirë gjeneratat më të moshuara në Kosovë, kanë “shkathtësi digjitale” në rrjetet sociale dhe aplikacione, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë, veçanërisht komunitetet pakicë, mbetet “plotësisht jashtë”.¹¹ Për shembull, një grua rome e përfshirë në konsultime për projektin e tyre raportoi se nuk kishte telefon ose nuk ishte në gjendje ta përdorte atë, duke ilustruar një hendek të thellë që statistikën e larta të lidhjes me internet nuk arrijnë ta pasqyrojnë.

Ky hendek midis disponueshmërisë teknike dhe përdorimit domethënës është gjetje thelbësore që pasqyrohet gjithashtu edhe në studimin rajonal të ReSPA, i cili thekson se përderisa Kosova posedon infrastrukturën, ajo has vështirësi në maturitetin e shërbimeve digjitale dhe përdorimin e tyre.¹² Për më tepër, ky hendek digjital nuk kufizohet vetëm te grupet e marginalizuara. Anketa Digjitale e UNDP-së e Ekonomive Familjare në vitin 2022 tregon se, pavarësisht qasjes së përgjithshme në internet, rreth 87% e qytetarëve në Kosovë përdorin internetin për komunikim të përgjithshëm dhe rrjete sociale, ndërsa përdorimi për funk-

“Një çështje e rëndësishme në procesin e digjitalizimit në Kosovë është “paradoksi i mbulimit”. Nga njëra anë, vendi ka shënuar progres të jashtëzakonshëm në sigurimin e lidhjes bazë. Nga ana tjetër, kjo qasje mbresëlënëse sasiore fsheh mangësi të konsiderueshme cilësore dhe barriera të vazhdueshme në hapësirën digjitale.”

7 ETF (2023) “Përqaftimi i epokës digjitale: E ardhmja e punës në Ballkanin Perëndimor”. Fondacioni Evropian për Trajnime.

8 Sajic, B. etj., (2024) “Raport i politikave mbi transformimin digjital në Ballkanin Perëndimor”. Përgjigjet e politikave.

9 Instituti Edutask (2025) “Eksplorimi i hendekut digjital midis grupeve të marginalizuara në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut”. QSNNN.

10 e-Kosova është një portal shtetëror ku shërbimet publike që gjenden në zyra dhe sportele fizike të institucioneve ofrohen në mënyrë elektronike. Shih më shumë - e-Kosova.

11 Re-ACT Lab (2025) Intervistë me znj. Sabelski, Menaxhere Projekti në GIZ Kosova.

12 Lauk, M. dhe Lemmik, J. (2023) “Studim rajonal i Ballkanit Perëndimor mbi digjitalizimit në qeveri”. Shkolla Rajonale e Administratës Publike.

sione më të avancuara si programimi, kodimi, puna me të dhëna ose përfitime të përgjithshme ekonomike mbetet shumë i ulët.¹³

Hendeku kritik në shkathtësi e rëndon edhe më shumë çështjen e qasjes, që përfaqëson një dështim të sistemit arsimor dhe të aftësisë për t'u përshtatur me epokën digjitale. Vazhdon të ketë mospërputhje të konsiderueshme midis shkathtësive të ofruara nga sistemi arsimor dhe kërkesave të procesit të digjitalizimit, sidomos të ekonomisë digjitale. Edhe pse të rinjtë në Kosovë përgjithësisht janë të njohur me mjetet digjitale, ata shpesh nuk kanë shkathtësi të avancuara dhe ndërsektoriale të nevojshme për punë me vlerë të lartë, veçanërisht në ekonominë gjithnjë e më të zgjeruar të profesioneve të lira dhe platformave.¹⁴ Këto mungesa veprojnë si pengesë e madhe për aftësinë konkurruese dhe rritjen ekonomike. Të dhënat nga studimi i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC) mbi shkathtësitë digjitale në vitin 2021 zbuluan se 44.2% e kompanive në Kosovë (përqindja më e lartë në rajon) identifikuan mungesën e fuqisë punëtore të edukuar si kufizim madhor operacional.¹⁵ Duke e theksuar më tej këtë sfidë, raporti i DESI për Ballkanin Perëndimor (BP) për vitin 2022 e rendit Kosovën nën mesataren rajonale në dimensionin e Kapitalit Njerëzor, duke vënë në dukje se vetëm 1% e ndërmarrjeve ofruan ndonjë formë trajnime të TIK për punonjësit e tyre më 2022.¹⁶ Një mungesë e tillë sistematike e shkathtësive është bllokadë e ndjeshme institucionale, e cila kufizon kapacitetin e shtetit për ta kapitalizuar infrastrukturën digjitale në vend.

Megjithëse ekosistemi digjital në Kosovë vazhdon të tregojë shenja gjallërie dhe zhvillimi, ky zhvillim mbetet i pabarabartë. Kjo pasqyron mospërputhjen midis arritjes së pranisë digjitale (disponueshmëria e teknologjisë) dhe arritjes së pjekurisë digjitale (përdorimi efektiv dhe inovativ). Dobësia e Kosovës në integrimin e teknologjisë digjitale nga bizneset u theksua në raportin DESI për Ballkanin Perëndimor (BP) në vitin 2022.¹⁷ Po ashtu, përdorimi i shërbimeve publike digjitale vazhdon të jetë përgjithësisht i ulët. Megjithëse portali e-Kosova u hap në vitin 2021, duke regjistruar më shumë se 700,000 përdorues dhe duke ofruar një gamë shërbimesh për qytetarët, përdorimi i tij në një shkallë më të gjerë ka qenë disi i kufizuar.¹⁸ Përgjithësisht, kënaqësia e qytetarëve me shërbimet elektronike raportohet të ketë rënë gjatë pandemisë COVID-19, dhe shumë qytetarë vazhdojnë të jenë të painformuar për ekzistencën e portalit ose e gjejnë të vështirë navigimin në të.¹⁹ Për më tepër, raporti i SIGMA-s mbi gatishmërinë për zbatimin e Rregullores së Portës së Vetme Digjitale e klasifikoi Kosovën për sa i përket zbatimit të shërbimeve kryesore online për ngjarje jetësore si “në fazë të hershme”.²⁰

13 UNDP Kosovë (2022) “Anketa digjitale e ekonomive familjare”.

14 Po aty, 7.

15 Labrovic Andjelkovic, J., etj., (2021) “Nevojat dhe hendeqet me shkathtësitë digjitale në Ballkanin Perëndimor”. RKK

16 Tintor, V., et al. (2022) “Ballkani Perëndimor: Indeksi i shoqërisë së ekonomisë digjitale (DESI) 2022. KBR

17 Po aty.

18 Po aty, 12.

19 Po aty

20 OECD (2025) “Porta e vetme digjitale në Ballkanin Perëndimor”. PUBLIKIM I SIGMA Nr. 74. Botim i OECD.

Përgjigja institucionale e Kosovës ndaj këtyre sfidave pengohet nga qeverisja e fragmentuar dhe vështirësitë e vazhdueshme. Përkundër një sinjali pozitiv të lëvizjes drejt një qasjeje kohezive “në nivel gjithë-qeveritar”, me strategjitë e kohëve të fundit, si Strategjia e Qeverisjes Elektronike 2023–2027 dhe Agjenda Digjitale e Kosovës 2030, zbatimi mbetet sfidues.²¹ Përgjegjësitë institucionale për digjitalizimin janë të shpërndara nëpër organe të ndryshme²², duke krijuar mungesë lidhesh dhe koordinimi të qartë. Ende nuk janë zhvilluar disa elemente të tjera kritike teknike dhe ligjore për një ekosistem digjital të maturuar. Për shembull, mungesa e nënshkrimit digjital funksional dhe të pranuar në mënyrë universale, si dhe sistemeve të integruara të pagesave elektronike, e kufizon potencialin e shërbimeve elektronike transaksionale, duke ndikuar te qytetarët dhe duke penguar rritjen e ekonomisë së platformës.²³

Për më tepër, sektori publik i Kosovës vuan nga “kufizimi me një furnitor” (vendor-lock-in)²⁴, gjegjësisht varësia e gjatë në një ofrues të vetëm teknologjie që limiton fleksibilitetin, rrit kostot dhe ngulfat inovacionin, duke krijuar ngurtësi institucionale në një fushë që kërkon agjilitet. Ky fragmentim bëhet edhe më i rëndë nga mungesa kritike e kapaciteteve brenda institucioneve publike. Një sfidë e ndjeshme është se departamentet e TI-së në institucione publike shpeshherë nuk kanë mjaftueshëm staf dhe nganjëherë të pakualifikuar. Kjo mungesë e burimeve të qëndrueshme njerëzore çon në atë që u përshkruar nga një ekspert si “kufoma softuerësh”: mjete digjitale dhe baza të dhënash të zhvilluara nga institucione të ndryshme që mbesin pa u përdorur sepse nuk ka kush t’i mirëmbajë, ose humben fjalëkalimet dhe llogaritë – duke shkaktuar humbje burimesh dhe duke cenuar qëndrueshmërinë e përpjekjeve për digjitalizim.²⁵

Goditja e hendekut digjital ka pasoja të thella dhe sistemike. Në aspektin ekonomik, kjo goditje kufizon produktivitetin, pengon rritjen e NVM-ve dhe e vendos Kosovën në disavantazh konkurrues.²⁶ Në aspektin shoqëror, ajo thellon

Mungesa e mundësive digjitale është gjithashtu shtytës i madh i ikjes së trurit, ku të rinjtë e kualifikuar kërkojnë perspektiva jashtë vendit, trend ky që po kërcënon bazën afatgjatë të kapitalit njerëzor të Kosovës.

²¹ Behluli, P. (2025) “Transformimi digjital në Kosovë: Navigimi në peizazhin e të dhënave dhe rruga përpara”. Re-ACT Lab.

²² Po aty, 12.

²³ Po aty.

²⁴ EGA (2024) “Formësimi i të ardhmes digjitale:” Udhëtimi i Kosovës në hartimin e Strategjisë së Qeverisjes Elektronike - intervistë me Zyrтарin Kryesor për Teknologji/Këshilltarin e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës” Fondacioni i Akademisë së Qeverisjes Elektronike.

²⁵ Po aty 11.

²⁶ Tintor, V., et al. (2018) “Ndikimi i transformimit digjital në Ballkanin Perëndimor - Përballimi i sfidave drejt stabilitetit politik dhe prosperitetit ekonomik”. WB6+ Digjital.

pabarazitë, duke kufizuar qasjen në arsim, informata shëndetësore dhe shërbime publike – sidomos për grupet veçse të marginalizuara. Mungesa e mundësive digjitale është gjithashtu shtytës i madh i ikjes së trurit, ku të rinjtë e kualifikuar kërkojnë perspektiva jashtë vendit, trend ky që po kërcënon bazën afatgjatë të kapitalit njerëzor të Kosovës.²⁷ Kjo dinamikë rrezikon të krijojë kurth të kapaciteteve institucionale, ku institucionet e dobëta nuk mbyllin hendekun e hendekut digjital, ndërsa mungesa e shkathtësive dhe stagnimi ekonomik e dobësojnë edhe më tej kapacitetin institucional – rreth ky vicioz.

Duke parë nga e ardhmja, rreziqet nga hendeku digjital pritet të intensifikohen. Meqë ekonomia globale mbështetet gjithnjë e më shumë në inteligjencën artificiale dhe analizën e të dhënave, hendeku digjital do të evoluojë në forma të reja përjashtimi, përfshirë një “ndarje të sigurisë” ku ata pa shkathtësi digjitale bëhen më të cenueshëm ndaj kërcënimeve kibernetike dhe dezinformimit.²⁸ Pa një kornizë rregullatore të fuqishme dhe adaptive, Kosova rrezikon të mbetet përjetësisht prapa dinamikës digjitale, pa qenë në gjendje ta shfrytëzojë potencialin transformues të teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm dhe mirëqenie shoqërore.



²⁷ Po aty, 7.

²⁸ Shoqëria e Internetit (2017) “Raporti global i internetit 2017: Rruga drejt së ardhmes sonë digjitale”.

Kuadri rregullativ

Si goditje, hendeku digjital prek një sërë çështjesh horizontale që shtrihen nëpër politika, ligje dhe rregullore të ndryshme. Korniza rregullative që adreson këtë goditje duhet të shkojë përtej promovimit të thjeshtë të aplikimit teknologjik, duke synuar ndërtimin e reziliencës dhe ndihmën për institucionet dhe shoqërinë që të përshtaten dhe t'i përballojnë pabarazitë rezultuese. Korniza aktuale rregullative është mjaft e kufizuar, dhe vërehet qartas një hendek midis ambicies strategjike dhe kapacitetit për zbatim. Fokusi kryesor aktual mbetet tek infrastruktura, e cila ende nuk përputhet me zhvillimin e kapitalit njerëzor, si dhe karakterizohet nga përgjegjësi të fragmentuara në institucione të ndryshme qeveritare.

Burimi kryesor rregullativ është Kushtetuta e Kosovës, e cila garanton të drejtat themelore që lidhen drejtpërdrejt me përfshirjen, si parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit dhe e drejta për arsim cilësor për të gjithë.²⁹ Në tërësi, këto garanci kushtetuese vendosin bazën për një shoqëri gjithëpërfshirëse të informacionit duke krijuar detyrim ligjor mbi shtetin që të sigurojë se përfitimet e çdo politike (në këtë rast të transformimit digjital) janë të qasshme për të gjithë qytetarët, pa paragjykim. Megjithatë, për të siguruar zbatimin efektiv të këtyre të drejtave dhe për të kontribuar në mbylljen e hendekut digjital, kushtetuta kërkon aprovimin e legjislacionit specifik mbështetës. Për shembull, ky vizion kushtetues vihet në praktikë përmes Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili përbën mjetin ligjor kryesor të cilin qytetarët mund ta përdorin për t'i sfiduar politikat ose shërbimet që i përjashtojnë ata në mënyrë disproporcionale.³⁰ Megjithëse ligji nuk e trajton drejtpërdrejt diskriminimin digjital, ai mund të përdoret në mënyrë interpretative për padi ligjore. Nuk ka raste të tilla në Kosovë, por ka në shtete të tjera. Për shembull, në vitin 2023, një gjykatë në Sllovaki vendosi në favor të një vajze rome e cila u privua nga qasja në arsim gjatë pandemisë COVID-19 për shkak të mungesës së teknologjisë dhe mjeteve digjitale. Gjykata i ofroi nxënësës kompensim financiar.³¹

“Niveli i parë” i hendekut digjital (qasja fizike dhe infrastruktura) trajtohet kryesisht nga Ligji për Komunikimet Elektronike. Ky ligj përcakton mekanizma për të siguruar shtrirjen e gjerë dhe të barabartë të rrjetit, siç është vendosja e detyrimit për “shërbime universale”, që ka për qëllim të ofrojë një numër minimal shërbi-

29 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 7, neni 47.

30 Ligji nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi. Neni 2.

31 Qendra për të drejtat civile dhe të njeriut (2023). Vendimi.

mesh për të gjithë përdoruesit në Kosovë, pavarësisht vendndodhjes gjeografike.³² Për më tepër, me ligj është themeluar Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i cili, ndër të tjera, mbron interesin e konsumatorit.³³ Qasja dhe infrastruktura e nivelit të parë realizohet tutje përmes intervenimit direkt të Projektit KODE, i cili luan rol kyç në zgjerimin e lidhjes digjitale përmes shtrirjes së lidhjes broadband me shpejtësi të lartë në zona që nuk ishin të lidhura ose që ishin të nën-shërbyera.³⁴ Projekti gjithashtu luan rol të rëndësishëm në “nivele të dytë” të hendeut digjital, pasi kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e shkathtësive të të rinjve përmes trajnimeve.

“Niveli i dytë” i hendeut digjital (shkathtësitë për të përdorur teknologjinë dhe kapaciteti për angazhim domethënës) trajtohet tutje me Strategjinë e Arsimit 2022–2026, e cila synon të adresojë hendeun kombëtar të shkathtësive.

Strategjia ka përcaktuar një objektiv strategjik për integrimin e mjeteve digjitale në sistemin arsimor në Kosovë, si dhe hartimin e kurrikulave me përfshirje të zhvillimit të zotësive digjitale në të gjitha nivelet arsimore.³⁵ Po ashtu, Agjenda Digjitale e Kosovës 2030 synon ta transformojë Kosovën në një ekonomi digjitale konkurruese, mes tjerash duke rritur edukimin dhe shkathtësitë digjitale të qytetarëve me qëllim të mbylljes së hendeut digjital.³⁶ Për më tepër, Strategjia dhe Plani i Zhvillimit Kombëtar 2030 e plotëson këtë duke e vendosur transformimin digjital dhe ndërtimin e shkathtësive digjitale si mundësues kyç ndërkultorial për shtyllat kryesore të saj, përfshirë “zhvillimin e barabartë njerëzor” dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Kjo e lidh drejtpërdrejt përfshirjen digjitale me objektivat zhvillimore të Kosovës.³⁷

Strategjia për Zhvillimin Industrial dhe Mbështetjen e Bizneseve 2030 (Politika Industriale) fokusohet në rritjen e aftësisë konkurruese të industrisë së Kosovës duke mbështetur tranzicionin digjital të bizneseve, veçanërisht të NVM-ve, me qëllim të rritjes së produktivitetit të tyre si dhe kapaciteteve inovative. Së fundmi, Strategjia e Qeverisjes Elektronike e Kosovës 2023–2027 ka vendosur fokus

“Edhe pse korniza e prezantuar rregullative është e gjerë dhe mbulon tema të ndryshme, hendeu digjital pothuajse asnjëherë nuk adresohet drejtpërdrejt, por shfaqet më shumë si botëkuptim i përgjithshëm i klauzolave dhe objektivave të mos-diskriminimit.”

³² Ligji nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike. Kapitulli V.

³³ Po aty. Neni 10

³⁴ Dokumenti i Vlerësimit të Projektit KODE.

³⁵ Strategjia e Arsimit 2022 - 2026. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Objektiva specifike 5.4.

³⁶ Agjenda Digjitale për Kosovën 2030. Objektivi strategjik 4.

³⁷ Strategjia dhe Plani Kombëtar i Zhvillimit 2030.

të fortë në mbylljen e hendekut të përdorimit në shërbimet publike, duke synuar digjitalizimin e plotë të proceseve administrative dhe ofrimin e tyre përmes një qasjeje me fokus te përdoruesi, veçanërisht përmes platformës e-Kosova. Për më tepër, strategjia shpjegon se kjo qasje mbështetet në parimet siç është rregulli i dërgimit të të dhënave “vetëm një herë”, për të përmirësuar angazhimin e qytetarëve si dhe efikasitetin e shërbimeve.³⁸

Edhe pse korniza e prezantuar rregullative është e gjerë dhe mbulon tema të ndryshme, hendeku digjital pothuajse asnjëherë nuk adresohet drejtpërdrejt, por shfaqet më shumë si botëkuptim i përgjithshëm i klauzolave dhe objektivave të mosdiskriminimit. Përderisa infrastruktura dhe qasja në infrastrukturën digjitale janë kryesisht të adresuara dhe veçse janë ndërmarrë veprime gjithëpërfshirëse, çështja e shkathtësive dhe përdorimit domethënës vazhdojnë të jenë dukshëm të paadresuara. Kjo kërkon fokus më të thelluar në ndërhyrje të ndryshme qeveritare.

38 Strategjia e Qeverisjes Elektronike të Kosovës 2023 - 2027.

Aplikimi i Kornizës së analizimit të politikave

Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi




Figura 2: Vlerësimi sipas kornizës së 4R-ve të ligjit nr. 05/L-021 për mbrojtje nga diskriminimi. (Burimi: Krijim i autorëve)

Ligji shërben si instrument i përgjithshëm juridik kundër pabarazisë. Megjithatë, ky ligj nuk është konceptuar me idenë e pabarazive digjitale dhe ka disa mangësi në këtë drejtim. Ligji është vlerësuar me 42%, duke shfaqur nivel të ulët të reziliencës.

Ligji paraqet qëndrueshmëri mesatare (notë 2), pasi ofron mbrojtje kundër diskriminimit. Ai përbën një bazë solide (ndonëse indirekte) ligjore që mund të aplikohet në mënyrë interpretative për rastet e diskriminimit/përgjashtimit digjital. Aftësia për të mobilizuar burime është gjithashtu mesatare (notë 2), pasi siguron kanale institucionale reagimi, përfshirë Avokatin e Popullit dhe procedurat formale të ankesave. Këto struktura lejojnë një shkallë fleksibiliteti institucional, ndonëse jo plotësisht të përshtatura me nuancat specifike të transformimit digjital. Shpejtësia e reagimit është e dobët (notë 1) sepse procedurat ligjore dhe administrative të disponueshme janë të ngadalta dhe burokratike. Edhe pse ekziston mundësia e zgjidhjes, mungojnë dispozitat emergjente apo mekanizmat për trajtim të shpejtë ("fast-track"), gjë që përbën joefikasitet madhor kur trajtohen çështje të ndjeshme në aspektin kohor, si qasja digjitale. Sa i përket kapaciteteve rezervë, ky është dështimi kryesor i ligjit (notë 0), meqë nuk

përcakton institucione alternative ose sisteme rezervë, duke mos lënë mundësi sigurie nëse dështojnë kanalet ligjore, nëse janë shumë të ngadalta, ose thjesht shumë të kushtueshme për t'u iniciuar.

Edhe pse ligji ofron reziliencë të ulët karshi hendekut digjital, vlera e tij qëndron në zbatueshmërinë e parimit të përgjithshëm kundër diskriminimit dhe përdorimit të kanaleve ekzistuese institucionale. Megjithatë, ndikimi praktik i ligjit është tejet i kufizuar për shkak të natyrës së tij të ngadaltë dhe burokratike. Edhe pse jo plotësisht i zbatueshëm, ligji duhet të zgjerohet me referenca të drejtpërdrejta për të drejtat dhe përjashtimet digjitale, duke kaluar nga botëkuptime të përgjithshme në garanci të qarta dhe të zbatueshme në epokën digjitale.

Ligji nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike




Figura 3: Vlerësimi sipas kornizës së 4R-ve të ligjit nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike. (Burimi: Analizë individuale).

Ky ligj është bazë për peisazhin rregullativ digjital në Kosovë, i hartuar enkas për të krijuar një treg konkurrues dhe të qasshëm për shërbimet elektronike. Për shkak të natyrës së tij, ligji nuk synon drejtpërdrejt adresimin e të gjitha çështjeve të hendekut digjital; megjithatë, vendos disa themele për të siguruar qasje të barabartë digjitale për të gjithë qytetarët. Ky ligji u notua me 58%, duke treguar reziliencë mesatare ndaj kësaj goditje.

Avantazhi parësor qëndron te aftësia për të mobilizuar burime (notë 3). Ligji nxit fleksibilitet duke inkurajuar ndarje të infrastrukturës dhe duke kërkuar bashkëpunim shumëpalësh midis aktorëve të ndryshëm.³⁹ Kjo është e rëndësishme sepse mundëson mobilizim më të mirë të burimeve dhe përshtatje ndaj sfidave të hendekut digjital. Qëndrueshmëria është mesatare (notë 2), pasi ligji ka themeluar me sukses institucione kyçe si Autoriteti Rregullativ, me rol thelbësor

³⁹ Po aty 32. Nenet 24 dhe 14.

në mbikëqyrjen e detyrimeve për shërbimin universal. Në anën tjetër, kapacitetet rezervë janë të dobëta (notë 1) sepse ligji mbështetet ndjeshëm te ofruesit e caktuar të shërbimeve universale për zgjerimin e qasjes së rrjetit dhe nuk vendos plane rezervë apo sisteme paralele që do të aktivizoheshin nëse ofruesit primarë nuk arrijnë të jenë funksionalë. Po ashtu, shpejtësia e reagimit është e dobët (notë 1); ndonëse ligji parashikon protokolle emergjence dhe komunikime prioritare, ato nuk zbatohen për çështje specifike të hendekut digjital, si ndërprerjet e qasjes në zona të nënshërbyera. Për më tepër, çdo mjet ankimi individual kërkon procedim gjyqësor, që zakonisht është i gjatë dhe i kushtueshëm.

Megjithëse ligji ofron reziliencë mesatare, kapacitetet e tij për alternativa dhe shpejtësi mbeten të kufizuara. Varësia e tepërt në një kanal të vetëm të ofruesve të shërbimit universal dhe mungesa e protokolleve specifike për kriza e bëjnë sistemin të cenueshëm dhe të ngadalshëm në reagim. Kjo kërkon ndërhyrje të qartë për të mbushur hendekun dhe për të siguruar që objektivi themelor i qasjes universale të realizohet plotësisht.

Projekti i Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE)




Figura 4: Vlerësimi i Kornizës së 4R-ve të Projektit KODE. (Burimi: Analizë individuale)

Projekti KODE përbën ndërhyrje kritike dhe të drejtpërdrejtë për adresimin e disa niveleve të çështjes së hendekut digjital. Projekti luan rol përcaktues në zgjerimin e rrjetit broadband me shpejtësi të lartë në zona të nënshërbyera dhe në rritjen e shkathtësisë digjitale të të rinjve përmes trajnimeve. Projekti demonstron reziliencë të lartë, duke marrë notë prej 92%.

Avantazhi parësor i projektit është aftësia e lartë për të mobilizuar burime (notë 3). Ai përdor një model inovativ të granteve konkurruese (matching grants) për të mobilizuar investime private nga ofruesit e shërbimeve të internetit (ISP), duke bashkë-financuar zgjerimin e rrjetit broadband në zona komercialisht jo të leverdishme. Kjo qasje fleksibile dhe bashkëpunuese midis qeverisë, sektorit privat dhe shoqërisë civile është tipari i tij më rezilient. Kapacitetet rezervë të pro-

jektit janë gjithashtu të larta (notë 3), pasi shfrytëzon rrjetin e zgjeruar për të forcuar sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe komunikimin në katastrofa, duke krijuar një funksion dytësor me vlerë. Shpejtësia e reagimit është po ashtu e lartë (notë 3), pasi projekti përdor teknologji reziliente që mundësojnë rimëkëmbje më të shpejtë dhe operim të vazhdueshëm gjatë emergjencave dhe ndërprerjeve. Gjithashtu, projekti mbështet edhe sistemet e paralajmërimit të hershëm për komunikim më të shpejtë në raste emergjence. Qëndrueshmëria është mesatare (notë 2); gjersa projekti zgjeron me sukses mbulimin me internet (duke synuar ndarjen urbane-rurale), ai zakonisht mbështetet në infrastrukturën kombëtare ekzistuese e cila nuk është plotësisht gjithëpërfshirëse.

Ky është projekt me rëndësi jetike për Kosovën. Intervenimi i tij adreson në mënyrë efektive hendekun kyç të lënë nga korniza më e gjerë rregullative dhe kontribuon në të dy nivelet e hendekut digjital. Megjithatë projekti është thelbësor, ka varësi të lartë në fonde të donatorëve, gjë që mund të rrezikojë mbylljen e tij në rast të shkurtimeve buxhetore. Kosova duhet të shfrytëzojë maksimalisht përfitimet e këtij projekti dhe të sigurojë që aktivitetet e tij - sido-mos ato që kanë të bëjnë me nivelin e dytë të hendekut digjital (shkathtësia dhe zotësia) - të integrohen në politika/strategji të tjera.

Strategjia e Arsimit 2022 - 2026




Figura 5: Vlerësim sipas Kornizës së 4R-ve të Strategjisë së Arsimit 2022 - 2026.

(Burimi: Analizë individuale)

Strategjia e Arsimit është politikë kyçe, veçanërisht për adresimin e “nivelet të dytë” të hendekut digjital përmes ndërtimit të shkathtësive dhe integritit të kompetencave digjitale në kurrikula në të gjitha nivelet arsimore. Strategjia ka reziliencë të ulët, duke marrë vlerësim prej 50%.

Qëndrueshmëria është mesatare (notë 2), pasi ofron një bazë strukturore për mbylljen e hendekut digjital duke identifikuar qasjen në TIK dhe shkathtësinë digjitale si thelbësore për arsimin cilësor. Edhe pse parasheh ndryshime në sis-

tem, si trajnimi i mësimdhënësve dhe digjitalizimi i kurrikulës, Strategjia nuk ka mekanizma të zbatimit dhe garanci konkrete që sigurojnë qasje për të gjithë nxënësit, pavarësisht prejardhjes së tyre. Aftësia për të mobilizuar burime është gjithashtu mesatare (notë 2); ajo tregon një fleksibilitet institucional përmes bashkëpunimit me komunat, por kapaciteti për të reaguar sipas nevojave lokale zbehet me mungesën e strategjive lokale të inovacionit, kufizimet e financimit dhe varësinë nga donatorët ndërkombëtarë. Kapacitetet rezervë janë të dobëta (notë 1), pasi ka mbështetje të lartë në platformat digjitale dhe mësimin online pa vendosur plane të mjaftueshme rezervë për nxënësit me qasje të kufizuar në internet. Po ashtu, shpejtësia e reagimit është e dobët (notë 1), sepse strategjia nuk ka mekanizma të përshpejtuar ("fast-track") për t'iu përgjigjur emergjencave të papritura që kanë të bëjnë me infrastrukturën digjitale ose mungesën e qasjes në të.

Strategjia ka vizion të qartë dhe të rëndësishëm afatgjatë për ngritjen e shkathëtsive digjitale në Kosovë, por reziliencia e ulët tregon se ajo nuk arrin t'i mbrojë nxënësit nga pabarazitë ekzistuese dhe goditjet e menjëhershme. Ndërsa strategjia vendos themelet për të ardhmen, në fazën aktuale, nuk adreson mjaftueshëm reziliencën e nevojshme në të tashmen.

Agjenda Digjitale e Kosovës 2030




Figura 6: Vlerësim sipas Kornizës së 4R-ve të Agjendës Digjitale për Kosovën 2030. (Burimi: Analizë individuale)

Agjenda Digjitale e Kosovës 2030 është dokument i rëndësishëm strategjik i hartuar për të drejtuar transformimin digjital të vendit. Ajo adreson disa nivele të hendekut digjital, duke synuar jo vetëm infrastrukturën, por edhe mbylljen e hendekut të shkathtësive përmes avancimit të edukimit digjital të qytetarëve. Agjenda vlerësohet me 75%, që tregon reziliencë mesatare.

Agjenda ka aftësi të lartë për të mobilizuar burime (notë 3), pasi nxit inovacionin duke planifikuar qendra inovacioni digjital, mbështet transformimin e NVM-ve

dhe synon shprehimisht rritjen e shkathtësisë digjitale të qytetarëve. Ky fokus si në kapitalin ekonomik ashtu edhe në atë njerëzor plotësohet me një qëndrueshmëri mesatare (notë 2), me plane të detajuara për agjencinë e sigurisë kibernetike dhe CERT-in kombëtar (Ekipi Kompjuterik për Reagim Emergjent) për mbrojtjen e infrastrukturës kritike. Kapacitetet rezervë janë gjithashtu mesatare (notë 2), duke treguar parashikim përmes përfshirjes së një qendre rikuperimi pas fatkeqësive, ndonëse do të mund të forcoheshin me sisteme më të larmishme paralele. Së fundi, shpejtësia e reagimit është mesatare (notë 2), me plane për një rrjet të koordinuar reagimi emergjent, ndonëse protokollet specifike për reagim të përshpejtuar “fast-track” mund të zhvillohen më tej.

Agjenda digjitale është dokument strategjik gjithëpërfshirës. Nota mesatare për reziliencë buron jo nga mungesa e vizionit, por nga pasiguria e zbatimit të plotë. Veprimet konkrete në implementim janë thelbësore që ajo ta realizojë potencialin e vet.

Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim (SPKZH) 2030




Figura 7: Vlerësimi sipas kornizës së 4R-ve i Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Zhvillim 2030. (Burimi: Analizë individuale)

SPKZH 2030 është kornizë gjithëpërfshirëse në nivel të lartë e cila në qendër vendos transformimin digjital. Duke e lidhur transformimin digjital me përfshirjen digjitale dhe ngritjen e shkathtësisë digjitale drejtpërdrejt me objektivat kombëtare, strategjia i jep drejtim të fortë adresimit të hendeikut digjital. Strategjia mori notë prej 83%, duke demonstruar reziliencë të lartë.

Strategjia ka qëndrueshmëri të lartë (notë 3) pasi integron në mënyrë strukturore transformimin dhe përfshirjen digjitale në planifikimin kombëtar, ciklin buxhetor institucional dhe kornizat e përafruara me BE-në. Aftësia për të mobilizuar burime është gjithashtu e lartë (notë 3), pasi krijon hapësirë për inovacion dhe zgjidhje problemesh të udhëhequra nga palët e interesit, duke promovuar mjete planifikimi dinamike të bazuara në të dhëna dhe duke mundësuar iniciativa

lokale të decentralizuara. Kapacitetet rezervë janë mesatare (notë 2); ofrohen në mënyrë të tërthortë përmes bashkëpunimit të shumë institucioneve, por mungojnë mekanizma specifikë rezervë ose mekanizma emergjentë nëse sistemet primare dështojnë. Shpejtësia e reagimit është po ashtu mesatare (notë 2), me afat të qartë zbatimi vjetor, por pa përgjigje ndaj kërkesave të paparashikuara ose urgjente digjitale.

Si strategji, është shumë e rëndësishme sepse e ngre transformimin dhe përfshirjen digjitale në nivelin më të lartë të politikave kombëtare. Strategjia duhet të marrë në konsideratë reagime më të shpejta për menaxhimin e goditjeve të menjëhershme digjitale.

Strategjia për Zhvillimin Industrial dhe Mbështetjen e Bizneseve 2030 (Politika Industriale)




Figura 8: Vlerësimi sipas kornizës së 4R-ve i Politikës Industriale 2030. (Burimi: Analizë individuale)

Strategjia është politikë e rëndësishme për Kosovën. Ajo fokusohet në rritjen e aftësisë konkurruese industriale duke mbështetur tranzicionin digjital të bizneseve dhe përgjithësisht e adreson hendekun digjital përmes prizmit ekonomik. Strategjia vlerësohet me 67%, që demonstroi reziliencë mesatare.

Qëndrueshmëria e strategjisë është mesatare (notë 2), pasi lidh me sukses digitalizimin me zhvillimin më të gjerë të sektorit prodhues. Megjithatë, kapaciteti i zbatimit dhe garancitë institucionale për infrastrukturën digjitale, veçanërisht në kontekste rurale dhe në kompanitë e vogla, trajtohen vetëm në mënyrë mesatare. Aftësia për t'i mobilizuar burimet është e lartë (notë 3) falë angazhimit aktiv të një game të gjerë aktorësh, përfshirë sektorin privat dhe atë financiar, për të zbatuar zgjidhje inovative. Strategjia përdor partneritete publike-private, programe aftësimi dhe financim të kombinuar për të nxitur adaptimin digjital brenda bizneseve. Kapacitetet rezervë janë mesatare (notë 2), meqë ndonëse promovon një kalim te mjetet dhe shërbimet digjitale për bizneset, mungojnë plan-

et e qarta rezervë ose rrugët alternative nëse adoptimi digjital ngec te disa grupe apo rajone. Së fundi, shpejtësia e reagimit është e ulët (notë 1), sepse ndërhyrjet e parashikuara nuk janë të krijuara për reagim afatshkurtër ndaj krizave; ato lidhen përgjithësisht me reforma strukturore afatgjata të orientuara te bizneset.

Strategjia ka reziliencë mesatare, edhe pse fokusohet kryesisht në hendekun digjital brenda sektorit të bizneseve në Kosovë. Megjithatë, progresi në mbylljen e hendekut digjital në këtë sektor kontribuon edhe në mbylljen e saj në nivel shoqëror.

Strategjia e Qeverisjes Elektronike të Kosovës 2023 - 2027





Figura 9: Vlerësimi i Kornizës së 4R-ve të Strategjisë së Qeverisjes Elektronike të Kosovës 2023 - 2027. (Burimi: Analizë individuale)

Kjo është strategji kyçe për të mbyllur “hendekun e përdorimit” në shërbimet publike, me synimin që proceset administrative të digjitalizohen plotësisht dhe të ofrohen përmes një qasjeje që vendos përdoruesin në qendër, veçanërisht përmes platformës e-Kosova. Strategjia demonstroi një nivel të lartë të reziliencës, duke marrë notë 83%.

Pikat e saj kryesore të forta janë qëndrueshmëria e lartë (notë 3) dhe kapacitetet rezervë të larta (notë 3). Strategjia vendos një sistem të fortë dhe të qëndrueshëm përmes dizajnit të mirë-zbatuar, me përdoruesin në qendër, dhe forcon sigurinë kibernetike. Më tej, zotimi i saj për qasje shumë-kanalëshe siguron redundancë të integruar mirë, duke garantuar vazhdimësi të shërbimit përmes masave të besueshme rezervë, si mbështetja me prezencë fizike dhe zyrtarë të trajnuar. Strategjia tregon aftësi të moderuar për të mobilizuar burime (notë 2) me plane ambicioze për ngritjen e shkathtësive digjitale në sektorin publik, si dhe nxitjen e inovacionit përmes partneriteteve publike-private. Shpejtësia e reagimit është mesatare (notë 2), pasi i mungon një mekanizëm i qartë për reagim të shpejtë në çështjet e hendekut digjital. Edhe pse janë themeluar trupat koor-

dinues për zbatim, si njësia e transformimit digjital, ata nuk janë të krijuar për ndërhyrje emergjente.

Avantazhi i kësaj strategjie është vizioni i saj për qeverisje digjitale me përdoruesin në qendër. Qëndrueshmëria dhe kapacitetet rezervë të larta krijojnë bazë të fuqishme që siguron stabilitet, përfshirje dhe vazhdimësi shërbimesh. Megjithatë, ka ende hapësirë për përmirësim për sa i përket shpejtësisë së reagimit dhe kohës së reagimit.



Diskutimi i gjetjeve

Vlerësimi sipas 4R-ve i kornizës rregullatore të Kosovës zbulon një sistem me reziliencë të moderuar, duke arritur një vlerësim të përgjithshme prej 68%. Kjo tregon se, ndonëse ekziston një bazë e arsyeshme e përgatitjes, ende ekzistojnë disa hendeqe kritike që ekspozojnë shoqërinë e Kosovës ndaj goditjes së hendekut digjital.

Tabela 5: Rezultati total i politikave të vlerësuara

#	Politikat	Vlerësimi	Pikët maksimale
1	Ligji nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi	5	96
2	Ligji nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike	7	
3	Projekti i Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE)	11	
4	Strategjia e Arsimit 2022 - 2026	6	
5	Agjenda Digjitale e Kosovës 2030	9	
6	Strategjia dhe Plan i Kombëtar për Zhvillim 2030	10	
7	Strategjia për Zhvillimin Industrial dhe Mbështetjen e Bizneseve 2030	8	
8	Strategjia e Qeverisjes Elektronike të Kosovës 2023 - 2027	9	
Gjithsej		65	68%

Në përgjithësi, korniza rregullative shfaq qëndrueshmëri të konsiderueshme në planifikimin strategjik në nivel të lartë. Strategjitë si Strategjia dhe Plan i Zhvillimit Kombëtar 2030 dhe Strategjia e Qeverisjes Elektronike 2023–2027 marrin vlerësime të larta duke e ngulitur transformimin dhe përfshirjen digjitale në zemër të politikës kombëtare dhe strukturës institucionale. Megjithatë, kjo forcë strategjike nuk reflektohet në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha nivelet. Për shembull, Strategjia e Arsimit 2022–2026 është vlerësuar me qëndrueshmëri mesatare sepse i mungojnë mekanizmat e zbatimit për të garantuar qasje për të gjithë nxënësit, pavarësisht prejardhjes. Kjo tregon një shkëputje të përgjithshme mes ambicies së lartë dhe realitetit në terren, duke çuar në paradoks mbulimi: ndërsa strategjitë synojnë përfshirjen, mungesa e zbatimit të fortë për komunitetet rurale dhe të marginalizuara bën që statistikisht mbresëlënëse të depërimit të internetit t'i maskojnë paparazitë e thella dhe vazhdueshme në cilësi dhe përdorim domethënës.

Rezultatet tona tregojnë se kapacitetet rezervë të kornizës rregullative janë dobësi kritike dhe sistemike. Burimet rregullative mbështeten vazhdimisht në zgjidhje me një shteg të vetëm, pa mekanizma të mjaftueshëm rezervë. Varësia e Strategjisë së Arsimit në platformat digjitale, pa ofruar mjete dhe mundësi për t'u qasur në to, është shembulli më i qartë i kësaj brishtësie - duke i lënë prapa nxënësit me lidhje të mangët ose pa pajisje. Redundanca është veçanërisht e ulët brenda ligjeve të vlerësuara si pjesë e kësaj kornize, pasi ato nuk ofrojnë rrugë alternative për qytetarët që nuk kanë mundësi dhe qasje për t'i ndjekur veprimet ligjore, sidomos në rastet e diskriminimit digjital. Edhe pse ligjet kundër diskriminimit janë të dobishme (siç pamë në rastin e Sllovakisë në BE), ato janë përgjithësisht shumë të ngadalta dhe të kushtueshme. Dështimi për të ndërtuar rrjeta të sigurisë ("safety nets") do të thotë se kur dështon një sistem primar, qoftë ai shërbim digjital, platformë mësimore apo proces ligjor, nuk ka kapacitet institucional për të përthithur goditjen dhe për të siguruar vazhdimësinë.

Për sa i përket aftësisë për të mobilizuar burime, korniza rregullative shfaq rezilientë të lartë. Kjo është pjesërisht e shtyrë nga modelet inovative të projektit KODE-së dhe SPKZH-së. Përfshirja e shumë palëve të interesit dhe planifikimi i decentralizuar janë pika të forta që nxisin fleksibilitet institucional në përballjen me goditje. Megjithatë, kapaciteti për mobilizim të burimeve nuk është sistemik. Kjo duket të jetë e përqendruar në projekte specifike ose strategji në nivel të lartë, ndërsa fushat themelore si arsimi shfaqin kapacitet mesatar të mobilizimit të burimeve. Kjo tregon se inovacioni është duke ndodhur në mënyrë të fragmentuar, bazuar në projekte, e jo si element i brendshëm sistemik, gjë që krijon rrezikun që progresi të mos jetë i qëndrueshëm pasi të mbarojnë fondet e veçanta të projekteve.

Së fundi, korniza demonstroi se ka nivel tejet të ulët të shpejtësisë së reagimit. Shumica e politikave dhe strategjive janë dizajnuar për reforma afatgjata dhe cikle shumëvjeçare, duke i bërë ato me aftësi të ngadaltë strukturore. Kjo inerci institucionale lidhet me qeverisjen e fragmentuar dhe pengesat e identikuara në tërë ekosistemin digjital të Kosovës. Pa mekanizma të reagimit të përshpejtuar ("fast-track") ose protokolle emergjente të integruara në kornizat ligjore ose strategjike për adresimin e hendekut digjital dhe për të garantuar transformim digjital gjithëpërfshirës, sistemi në thelb është i papërgatitur për t'u përballur me ndërprerjet, duke i lënë qytetarët të pambrojtur pikërisht kur atyre u duhet mbështetje.

"Dështimi për të ndërtuar rrjeta të sigurisë ("safety nets") do të thotë se kur dështon një sistem primar, qoftë ai shërbim digjital, platformë mësimore apo proces ligjor, nuk ka kapacitet institucional për të përthithur goditjen dhe për të siguruar vazhdimësinë."

"Pa mekanizma të reagimit të përshpejtuar ("fast-track") ose protokolle emergjente të integruara në kornizat ligjore ose strategjike për adresimin e hendekut digjital dhe për të garantuar transformim digjital gjithëpërfshirës, sistemi në thelb është i papërgatitur për t'u përballur me ndërprerjet, duke i lënë qytetarët të pambrojtur pikërisht kur atyre u duhet mbështetje."


Konkluzione dhe rekomandime

Ndërtimi i një shoqërie digjitale gjithëpërfshirëse dhe reziliente është përpjekje komplekse dhe afatgjate. Për Kosovën, ky rrugëtim kërkon një zhvendosje nga qasja që fokusohet vetëm në zgjerimin e infrastrukturës teknologjike drejt një vizioni që në fokus ka njerëzit, ku shkathtësitë, mendimi kritik dhe mësimi tërëjetësor janë gurthemel i çdo politike kombëtare që ka të bëjë me transformimin digjital. Sfida qendrore e vendit, “paradoksi i mbulueshmërisë”, është dëshmi e qartë pikërisht për këtë nevojë. Tejkalimi i saj kërkon të dilet përtej trajnimeve afatshkurtra të bazuara në projekte, duke e ngulitur kompetencën digjitale në vetë strukturën e shoqërisë, nga vitet e para të shkollës e deri te bashkëveprimet ditore ndërmjet qytetarëve dhe shtetit.

Prandaj, ndërhyrja më kritike dhe më transformuese qëndron te reformat e thella të sistemit arsimor kombëtar. Edhe pse Strategjia e Arsimit 2022–2026 fokusohet në ngritjen e shkathtësive digjitale dhe digjitalizimin e sistemit arsimor, reziliencia e saj mbetet relativisht e ulët. Meqë sistemi është duke lëvizur drejt mjeteve digjitale, është thelbësore që strategjitë e arsimit t’i adresojnë çështjet që kanë të bëjnë me hendekun digjital. Kosova duhet ta miratojë Strategjinë shtetërore të edukimit digjital multimodal (multiliteracy), ngjashëm me qasjen sistemike të Finlandës.⁴⁰ Kjo nuk do të thotë vetëm shtim i një lënde tjetër të TIK-ut në kurrikulë; por reformë themelore pedagogjike që integron edukimin digjital dhe mediatik si

“Ndërtimi i një shoqërie digjitale gjithëpërfshirëse dhe reziliente është përpjekje komplekse dhe afatgjate. Për Kosovën, ky rrugëtim kërkon një zhvendosje nga qasja që fokusohet vetëm në zgjerimin e infrastrukturës teknologjike drejt një vizioni që në fokus ka njerëzit, ku shkathtësitë, mendimi kritik dhe mësimi tërëjetësor janë gurthemel i çdo politike kombëtare që ka të bëjë me transformimin digjital.”

⁴⁰ Shih më shumë: Agjencia Kombëtare e Arsimit në Finlandë - Shkathtësitë e Shumëfishta dhe Edukimi Mediatik



kompetenca ndërsektoriale në të gjitha lëndët dhe nivelet e arsimit. Në praktikë, kjo do të thotë, mes tjerash, që nxënësit të mësojnë të analizojnë të dhëna në lëndën e matematikës, të krijojnë rrëfime historike digjitale në histori dhe të vlerësojnë informacionin shëndetësor në internet në edukatë fizike. Qëllimi i kësaj reforme është zhvillimi i të menduarit të sofistikuar kritik, kuptimit etik dhe aftësisë jo vetëm për të konsumuar, por për të prodhuar, krijuar dhe ndikuar në botën digjitale. Kjo reformë sistematike është një nga investimet më të rëndësishme afatgjata që Kosova mund ta ndër marrë për të kultivuar një brez qytetarësh të fuqizuar, rezilientë dhe adaptues, të përgatitur për transformimin e planifikuar digjital.

Përtej arsimit formal, dështimi më kritik i kornizës, gjegjësisht mungesa e kapaciteteve rezervë, duhet të adresohet përmes krijimit të një ekosistemi shërbimesh publike me kanale të shumta, me parimin “nuk ka zyre të gabuar”, që garanton qasje për këdo. Qasje me fokus ekskluziv digjital përjashton në mënyrë të natyrshme qytetarët me qasje, shkathtësi ose besim të kufizuar, duke minuar vetë qëllimin e e-shërbimeve publike. Një mënyrë e mundshme për adresimin e kësaj çështjeje është krijimi i rrjetit kombëtar të “Pikave qytetare”, sipas modelit “Espaço Cidadão” në Portugali.⁴¹ Këto qendra fizike, brenda infrastrukturës komunale ekzistuese, do të angazhonin mentorë me trajnime digjitale që ofrojnë mbështetje praktike, të asistuar digjitale. Ky intervenim duhet të plotësohet me detyrimin ligjor për “Asistencë digjitale” për të gjitha shërbimet publike elektronike, ngjashëm me kornizën e Mbretërisë së Bashkuar “Digital by Default, not Digital Only” (Digjitale sipas konfigurimit, jo ekskluzivisht digjitale),⁴² duke sigu-

⁴¹ Shih më shumë: Portali Portugez Online - Shërbimi në Pikat Qytetare

⁴² Shih më shumë: Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar - Mbështetje digjitale me asistencë

ruar që mbështetja me staf të trajnuar, si përmes telefonit si me prani fizike është gjithmonë në dispozicion si opsion alternativ, sidomos për personat në zona rurale ose ata me lëvizshmëri të kufizuar që nuk mundën të përfitojnë nga “pikat qytetare”.

Për të rritur kapacitetin për të mobilizuar burime dhe aftësinë konkurruese ekonomike, Kosova duhet të zhvillojë një ekosistem inovativ që mbështet ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), të cilat aktualisht mbeten prapa në adaptimin digjital. Nuk mjafton vetëm ndarja e granteve për teknologji, madje, kjo praktikë shpeshherë nuk është fare e mirë. Kërkohet një qasje më strategjike; p.sh., lidhja e stimuljeve financiarë me udhëzim strategjik. Kualifikimi i NVM-ve për subvencione shtetërore të digjitalizimit duhet të kushtëzohet së pari me zhvillimin e një plani formal të digjitalizimit (që përfshin qasjen në teknologji dhe ngritjen e shkathtësive), në vijë me strategjitë kombëtare të transformimit digjital. Kjo do të siguronte shfrytëzim të fondeve publike për transformim të vërtetë afarist, duke mbuluar edhe avancimin e teknologjisë edhe të shkathtësive të punonjësve, dhe do të adresonte drejtpërdrejt dështimet e tregut që pengojnë rritjen e NVM-ve. Një qasje e ngjashme është aplikuar në Gjermani në rrugëtimin e saj drejt transformimit digjital.⁴³

Në të njëjtën kohë, korniza rregullative aktuale ka shpejtësi të ulët reagimi, gjë që kërkon përmirësim. Kjo duhet bërë duke krijuar një mekanizëm më të shkathët për reagim emergjent. Sistemi aktual nuk është i pajisur për të përballuar goditje të papritura që ndërpresin qasjen në shërbime, digjitale apo fizike, siç janë pandemitë ose katastrofat natyrore. Për ta adresuar këtë, Kosova duhet të krijojë një Fond Kombëtar për Emergjencë Digjitale, sipas modelit të “Fondit për Lidhje Emergjente në SHBA”⁴⁴, me fonde të mjaftueshme për prokurim të shpejtë të pajisjeve dhe lidhjes për grupet e cenueshme gjatë kohëve të krizave. Kjo është veçanërisht kritike për nxënësit të cilëve u mungon teknologjia e duhur për qasje në mjetet e tyre arsimore digjitale. Tutje, fondi duhet të pasohet me Protokollin e Përfshirjes Digjitale për Reagim të Shpejtë, i hartuar bashkërisht me të gjithë aktorët, dhe i cili përfshin një Skemë të Parapërgatitur të Kuponëve Socialë (sipas modelit të masave të reagimit ndaj krizave në BE⁴⁵) për të ofruar lidhje të menjëhershme për personat në nevojë.

Së fundi, të gjitha këto intervenime duhet të mbështeten me qëndrueshmëri të qeverisjes dhe rregullimit ligjor. Për përcaktimin e të drejtave të qarta dhe për parandalimin e krijimit të barrierave të reja është thelbësore të zbatohen reforma, siç është ndryshim-plotësimi i Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, veçanërisht duke përfshirë dhe përkufizuar qartas “përfshirimin digjital”, dhe aplikimi i legjislacionit për mandatin “Përfshirja strukturore digjitale” bazuar në Aktin Evropian për Qasshmëri.⁴⁶

“Sistemi aktual nuk është i pajisur për të përballuar goditje të papritura që ndërpresin qasjen në shërbime, digjitale apo fizike, siç janë pandemitë ose katastrofat natyrore.”

⁴³ Shih më shumë - Ministria Federale Gjermane për Çështje ekonomike dhe të energjisë - Financimi “Digital Now” për digjitalizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

⁴⁴ Shih më shumë - Fondi i për lidhje emergjente USAC

⁴⁵ Shih më shumë - Komisioni Evropian (n.d) Vauçerët socialë për të mbështetur lidhshmërinë për refugjatët nga Ukraina.

⁴⁶ Shih më shumë: Komisioni Evropian - Akti Evropian për Qasshmëri

Prurëtimi nga prania digjitale te pjekuria digjitale kërkon strategji të integruar që kombinon reformat sistematike arsimore me shërbime të fuqishme publike, ekonomi dinamike dhe institucione reziliente. Përqafimi i kësaj qasjeje gjithëpërfshirëse, me njerëzit në qendër, do ta mundësojë Kosovën që ta tejkalojë paradoksin e mbulueshmërisë dhe të ndërtojë një shoqëri digjitale të barabartë, konkurruese dhe të sigurt, plotësisht të përafruar me të ardhmen e saj evropiane.

